



UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
Plani Strategjik
2018-2024

Përmbajtje

NR	KREU	FAQE
1	PARATHËNIE	4
2	PLANI STRATEGJIK DHE RENDESIA	5 - 6
3	METODOLOGJIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK	7 - 19
4	ANALIZA SWOT	20 - 22
5	KUADRI STRATEGJIK	22 - 26
6	FJALET KYCE	26
7	SKENARET E ZHVILLIMIT, LINJAT STRATEGJIKE	27 - 36
9	QELLIMI DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE	37 - 41
10	PLANI I VEPRIMIT NË FUNKSION TË OBJEKTIVAVE DHE INISIATIVAVE STRATEGJIKE.	42 - 76
11	PLANI FINANCIAR	77

SHKURTIME

Bordi i Administrimit	BA
Bashkimi Evropian	BE
Universiteti i Vlores	UV
Fakulteti i Ekonomise	FE
Fakulteti i Shendetit Publik	FSHP
Fakulteti i Shkencave Teknike	FSHT
Fakulteti i Shkencave Humane	FSHH
Strategjia Kombetare per Integrim dhe Zhvillim	SKZHI
Sustainable Development Goal – Objektivat e zhvillimit te qendrueshem	SDG
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise	MASR
Drejtorite Rajonale Arsimore	DAR
Insittucionet e Arsimit te Larte	IAL
International Maritime Organisation	IMO
Vendim I Keshillit te Ministrave	VKM
Keshilli I Profesoreve	KP
Klasifikimi Dhjetor Universal	KDHU
Life Long Learning	LLL
Master Profesional	MP
Master Shkencor	MS
Qendra per Kerkim Shkencor	QKSH
Senati Akademik	SA
Sigurine e Cilesise dhe Akreditimit	SCA
Sistemi i Menaxhimit te Informacionit	SMI
Sistemi i Menaxhimit Universitar	UMS
Qendra e Studimeve Mjedisore	QSM
Statuti dhe Rregullorja e Universitetit	SRU
Ligji Per Arsimin e Larte	LAL
Personat me aftësi të kufizuara	PAK
European Qualification of Skills/ Competences Qualification and Ocupations.	ESCO

PARATHËNIE

Ky dokument paraqet një përmbledhje të procesit të planifikimit strategjik të kryer në Universitetin e Vlores . Gjithashtu, ai shpjegon se si është aplikuar metodologjia e planifikimit strategjik në Universitet, mënyrën se si aktorët u përfshinë në proces dhe rezultatet e arritura.

Përshkruan situatën aktuale të Universitetit dhe ilustron strategjinë e përbashkët të zhvillimit të qëndrueshëm, e cila u zgjodh nga komuniteti i studentëve, stafëve akademike dhe administrative. E gjithë përmbajtja e tij u nda me aktorët territorialë dhe/ose u hartua mbi bazën e sugjerimeve dhe studimeve të tyre.

Rrjedhimisht, Plani Strategjik nuk pretendon të jetë shterues dhe mund t'i nënshtrohet unifikimeve dhe shtesave në çdo kohë. Në tërësi, ky dokument përfaqëson një përmbledhje të asaj që rezultoi nga procesi i negociimeve demokratike, që ishte baza e programit të planifikimit strategjik. Rrjedhimisht, ai është një dokument i hapur, gjithëpërfshirës dhe i ndryshueshëm.

Nëse është e nevojshme mund të përditësohet, gjithnjë nëpërmjet përfshirjes të të gjithë komunitetit të studentëve, pedagogëve, stafit administrative dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Organet drejtuese të UV duhet ta përdorin këtë dokument si memorandum dhe si një udhëzues për zbatimin gradual të projekteve të koordinuara të zhvillimit në institucion e me gjërë.

Natyra pjesëmarrëse e Planit Strategjik garanton vazhdimësinë dhe legjitimitetin e strategjisë së zhvillimit. Fakti që kjo strategji u propozua nga shumica e stafëve akademike dhe administrative duhet të merret parasysh nga administratorët aktualë dhe të ardhshëm për të përmbushur pritshmëritë e komunitetit të studentëve dhe pedagogëve për periudhën 5 vjeçare.

I. PLANI STRATEGJIK DHE RENDESIA

Ky dokument, i hartuar nga Rektorati mbi bazën e propozimeve të ardhura nga departamentet si njesite baze, fakultetet, me miratim të dekanateve paraqet në mënyrë të detajuar strategjinë e Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës (UV), për zhvillimin e tij të në periudhën 2018-2024.

Hyrja në fuqi e Ligjit të ri të Arsimit të Lartë, si dhe konkurenca e lartë midis Universiteteve publike e private, përcaktoi në mënyrë të detyrueshme nevojën për rishikimin e skenareve të zhvillimit të Universitetit, rishikimin e prioriteteve ekzistuese dhe hartimin e prioritete të reja nisur nga statusi aktual që u jep ligji.

Universitetet tashmë nuk janë vetëm qendra të mësimdhënies, por pole të rëndësishme të zhvillimit të territoreve, përmes kërkimit shkencor në përputhje me nevojat e tregut, një bashkëpunimi të ngushtë me të gjithë aktorët publikë dhe private në territor si dhe rritjes dhe zgjerimit të kooperimit ndërkombëtar.

Ky vizion i ri për arsimin e lartë, i imponuar edhe nga konkurenca me universitete të huaja, sjell drejt nevojës së hartimit të një plani të ri strategjik, i cili do të mishërojë këtë vizion.

Strategjia e zhvillimit të Universitetit “Ismail Qemali” mbështetet gjerësisht në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI 2015-2020), Strategjine Kombetare për Implementimin e SDG (Sustainable Development Goals) - Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Programi për Zhvillim (UNDP), ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar.

Prej një periudhe të gjatë disa muajore, ajo u konsultua nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës të studenteve, pedagogëve, grupeve të interesit në departamente si njësi baze, fakultete, qendrave të kërkimit shkencor dhe zhvillimit në Universitet. Nisma për hartimin e Strategjisë 2018-2024 të Universitetit të Vlorës erdhi si një nevojë imediate pas përfundimit të procesit të akreditimit të Universitetit të Vlorës dhe rekomandimeve të dhëna për përmirësim.

Procesi i akreditimit diktoi një reflektim të UV-se në lidhje me ndryshimet në strategjinë e drejtimit dhe menaxhimit të institucionit, duke rritur efektivitetin e përdorimit të aseteve të tij në burime njerezore, infrastrukture, shërbime mbështetëse për studentet, burimet financiare të tij, partneritete kombëtare, ndërkombëtare, duke patur në konsideratë pozicionin strategjik gjeografik të tij.

Procesi ndihmon ndjeshëm në zhvillimin e një sërë parimesh të përgjithshme për zhvillim si dhe hartimit të një sërë praktikash dhe udhëzimesh në funksion të rritjes së efektivitetit të institucionit.

Strategjia aktuale u ndërtua, bazuar në këtë analizë, duke patur si qëllim kryesor përmirësimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet që Universiteti kryen. Politikat dhe masat operative që propozohen si pjesë e kësaj strategjie, e drejtojnë UV në mënyrë të qëndrueshme në përmbushjen e objektivave ekzistuese, si dhe hartimin e objektivave të reja në përputhje me ritmet dinamike të zhvillimit të tij.

Plani Strategjik i UV-së është hartuar mbi frymën e prioriteteve të Strategjisë së Zhvillimit të institucionit si dhe mbi planifikimet strategjike të Fakulteteve, njësitë bazë akademike, administrative dhe financiare, sipas qasjes nga poshtë-lart (bottom – up) në një proces gjithëpërfshirës të stafit akademik, jo akademik dhe atij studentor, me skenarë të pranuar zhvillimi, të detajuar në linja strategjike zhvillimi, plane veprimi për çdo linjë strategjike dhe projekte konkrete të shoqëruara me planifikimin e duhur financiar për t'i implementuar ato.

Kjo strategji synon që të krijojë një sërë vlerash institucionale, të cilat do të pasurojnë infrastrukturën akademike dhe atë institucionale në përgjithësi. Në përpjekjen për të kuptuar qëllimin e kësaj strategjie, është patur parasysh sa më poshtë vijon:

- Strategjia e Universitetit nuk është një dokument statik, por një dokument dinamik në përpunim, korrigjim dhe përmirësim të vazhdueshëm, në përputhje me dinamikën e zhvillimit të Institucionit në vite. Ajo është një qasje e rëndësishme, e cila është e hapur për përpunim, përmirësim si edhe ndërhyrje korrigjuese në përputhje me kushtet dhe prioritetet e zhvillimit rajonal dhe kombëtar. Ky është një dokument afatgjatë që duhet të rishikohet dhe zhvillohet vazhdimisht, me qëllim që të jetë shprehje e fleksibilitetit dhe përshtatshmërisë në një mjedis i cili ndryshon shpesh dhe shpejt.
- Realizimi i këtij dokumenti ka nevojë për përpjekje të mëdha në të gjitha nivelet, kohë të gjatë implementimi dhe financim të vazhdueshëm e të konsiderueshëm. Në këtë aspekt, për implementimin sa më të mirë të saj, është i nevojshëm një bashkëpunim midis autoriteteve drejtuese të UV-s, personelit akademik, personelit ndihmës akademik dhe administrativ.
- Implementimi korrekt i një strategjie zhvillimi afatgjate synon të amortizojë riskun që vjen prej autonomisë së kufizuar, mungesës apo pamjaftueshmërisë së financimit si dhe ndryshimet e vazhdueshme ligjore në Ligjin e Arsimit të Lartë (LAL).

UV është në një periudhë përcaktuese të historisë së tij 24 vjeçare, atë të krijimit të një vizioni të ri në përputhje me objektivat dhe progresin e vendit drejt integritetit në BE. Ky vizion duhet të marrë parasysh nevojat e tregut për figura profesionale të kualifikuara sipas standardeve ESCO të BE-së, të afta për të gjeneruar praktika të qëndrueshme zhvillimi në kontekstin evropian.

II. METODOLOGJIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Planifikimi Strategjik është konsideruar si proces i rishqyrtimit dhe vlerësimit i shoqëruar vazhdimisht nga procedurat e monitorimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes.

Hartimi i tij është bazuar në katër hapa kryesore.

1. Hyrja/Prezantimi
2. Struktura e Analizes
3. Kuadri Strategjik
4. Plani i Veprimit

1. Hyrja/ Prezantimi

Informimi: Universiteti e nisi procesin e Planifikimit Strategjik me një prezantim të kësaj nisme tek stafi akademik, ndihmës akademik gjatë mbledhjeve të departamenteve dhe fakulteteve ku dhe u dorëzuan materialet udhëzuese për ndërtimin e këtij plani, duke theksuar qëllimin e tij dhe instrumentat për ta realizuar atë.

Departamentet si njësitë bazë të UV-së u përfshinë në një proces informimi rreth rëndësisë së hartimit të një Plani Strategjik, metodologjisë duke përfshirë qasjen nga poshtë lart (bottom -up) për të identifikuar problematikat dhe prioritetizuar ndërhyrjet strategjike.

Identifikimi: U realizua identifikimi i target-grupeve që do të përfshiheshin në një proces të gjerë konsultimesh në departamente dhe fakultete, përfshirë këtu edhe grupet e interesit që në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë ndikojnë në politikat e zhvillimit të Universitetit dhe që natyrshëm u bënë pjesë aktive e diskutimit dhe konsultimit rreth prioritetëve të zhvillimit në përputhje me trendin e zhvillimit social ekonomik rajonal, kombëtar dhe Europian.

2. STRUKTURA E ANALIZES

2.1 HISTORIK I SHKURTËR I UV

Universiteti i Vlorës u themelua në 10 tetor 1994, me Vendim të Këshillit të Ministrave N.105, Dt.28.02.1994. Universiteti “Ismail Qemali” është një realitet i pakundërshtueshëm ndër institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Për hapjen e tij u bë një punë disa mujore për përgatitjen e planeve, programeve dhe përzgjedhjen e stafit

akademik, me ndihmë shumë të madhe nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe i Mjekësisë të Tiranës.

Universiteti filloi aktivitetin me tri Fakultete:

- Tregetisë (me degët Biznes dhe Turizem),
- Inxhinierisë Detare dhe
- Infermierisë.

Përzgjedhja e këtyre fakulteteve u bë mbi bazën e traditës që ekzistonte në Vlorë për këto disiplina. Prej vitit 1919, në qytet është hapur shkolla e mesme Tregtare, një ndër shkollat më të mira të vendit në atë kohë. Traditat e saj u pasuruan kur në Vlorë u hap filiali i Universitetit të Tiranës për degën e Ekonomikut, e cila funksionoi në vitet 1970-1980.

Prej vitit 1960, në Vlorë funksiononte Shkolla e Lartë e Marinës, tradita e të cilës në shumë aspekte shërbeu si bazë për Fakultetin e Inxhinierisë Navale (sot Fakulteti i Shkencave Teknike). Fakulteti i Infermierisë u ngrit mbi traditën e Shkollës së Mesme Mjekësore, e vetmja në vendin tonë, e cila u transferua në Vlorë në 1967 deri në krijimin e vetë fakultetit.

Për organizimin e gjithë punës përgatitore të ngritjes së Universitetit u krijua një grup pune i drejtuar nga Dr. Sezai Bazaj, i cili më pas u emërua dhe Rektor i këtij institucioni.

Universiteti filloi punë në dy godina me 162 studentë, në të katër degët e tij. Fillimisht stafi akademik përbëhej nga 10 pedagogë të brendshëm dhe 31 pedagogë të jashtëm, të cilët, si pionierë të parë të kësaj armate, me përgatitjen e tyre profesionale e shkencore vlerësuan me përkushtim të lartë misionin që kishin nisur. Në fillimit e tij emërtimi i Universitetit ishte "Universiteti Teknologjik Ismail Qemali Vlorë". Prej vitit 2007 Universiteti mban emrin Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës. Nga viti në vit UV filloi të rritet si në numrin e degëve të reja, ashtu edhe atë të studenteve dhe pedagogëve të brendshëm.

Larmia e programeve studimore të UV filloi të orientohej edhe drejt programeve të tjera studimore si: Gjuhëve të Huaja, Mësuesi, Teknologji Informacioni, Inxhinieri Elektrike, Shkenca Navigacionale, Drejtësi, Inxhinieri Mekanike, etj, duke ju përshtatur kërkesave të komunitetit të rajonit Jugor të Shqipërisë për formimin e specialistëve të fushave të sipërpërmendura. Sot, Universiteti numëron programe studimi të ciklit të parë, të dytë dhe studime të ciklit të tretë (PhD në Matematikë). Prej vitit akademik 2004-2005, UV filloi strukturimin e programeve në përputhje me kërkesat e procesit të Bolonjës si dhe të krediteve ECTS.

Shumëllojshmëria e programave të hapura, si dhe faktorë të tjerë të brendshëm e të jashtëm, që lidhen me punën mësimore dhe shkencore, diktuan edhe rritjen cilësore dhe sasiore të kualifikimit të stafit akademik.

Gjatë gjithë periudhës së ekzistencës, UV ka patur dhe vijon të ketë në qendër të vëmendjes kualifikimin e pandërprerë të pedagogëve, brenda dhe jashtë vendit. Një kontribut shumë të madh për ngritjen cilësore të kualifikimit të stafit akademik të UV ka dhënë Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Universiteti i Tiranës.

Në kuadrin e rritjes cilësore dhe përmirësimit të vazhdueshëm të imazhit brenda dhe jashtë vendit, që prej themelimit të tij, UV ka organizuar jo pak konferenca me karakter shkencor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Konferenca e parë shkencore në nivel kombëtar u organizua në 1996 (dy vjet pas hapjes së Universitetit) mbi “Arritjet në fushën e kirurgjisë”. Konferenca e parë shkencore ndërkombëtare “Mbi turizmin alternativ dhe të qëndrueshëm” u zhvillua në vitin 2002, me iniciativën e Ambasadës Italiane. Disa konferenca të tjera të rëndësishme shkencore ndërkombëtare kanë qenë: “Neë Challenges in Digital Communications” e mbështetur nga “NATO Advanced Study Institute” (28 Prill - 9 Maj 2008); “Financial Challenges and Economic Perspectives”. (12-15 Maj 2009): “Applications of Computer Algebra, ACA’10” (24-27 Qershor 2010): “Free Softëare in Balkans 2010” (11-12 Shtator 2010).

Prej themelimit të tij, UV ka vijuar përpjekje për një bashkëpunim të vazhdueshëm e të frutshëm me shumë Universitete të vendeve të rajonit, Evropian e të Sh.B.A-ve. Gjate historikut te tij 24 vjecar është rritur numri i universiteteve me të cilët UV ka bashkëpunuar te tilla si: Universiteti i Leçes, Barit, Mesines, Perugias, Kozencës (Itali), Liezhit (Belgjike), Kretës (Greqi), Universiteti i Talin (Estoni), Universiteti i Turku-t (Finlandë) Universiteti i Vigo-s, Valencia -s (Spanjë), Universiteti i Nish-it (Serbi), Universiteti i Shkencave Natyrore Sofje (Bullgari), Universiteti i Timisoharës (Rumani), Universiteti I Alesundit (Norvegji) etj.

Këto marrëveshje përfshijnë kryesisht kualifikime të pedagogëve, vizita nga stafi i UV dhe studentëve, bashkëpunim në kërkime studimore shkencore si dhe shkëmbime përvojash. Universiteti filloi punën me një kabinet modest të Fizikës dhe disa kabinete të Infermjerisë të trashëguar nga shkolla e mesme mjeksore.

Aktualisht UV ka kabinete dhe laboratore të shumta si kabinetet e informatikës, Infermieristikës, Navigacionit, Inxhinierisë Detare, Laboratorin e Fizikës, Kimisë, Biologjisë, Laboratorin e Studimeve Ambientale etj, pajisje te kompletuara hardëare dhe softëare, si dhe një teknikë e pasur audio-vizive për transmetimin e njohurive.

Gjatë këtyre viteve është rritur numri i studentëve dhe është zgjeruar gjeografia e zonave nga ata vijnë duke përfshirë jo vetëm qarqet e Shqipërisë së Jugut por edhe studentë nga Tirana, Durësi, Kukësi, Lezha, Kruja etj.

Po ashtu në mënyrë të ndjeshme është rritur pjesëmarrja e UV-së si partner në projekte ndërkombëtare të financuara ne kuadër të programeve të Komunitetit Evropian si Erasmus+, IPA CBC 1 dhe 2, INTERREG MED, Tempus etj.

2.2 Organizimi dhe menaxhimi i UV [1]

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë ka ngritur struktura funksionale me qëllim përmbushjen e misionit dhe objektivave të tij. Organizimi dhe funksionimi i UV mbështetet si tek autoritetet drejtuese ashtu edhe tek organet kolegjiale të cilat garantojnë rrahje të mendimeve, debat konstruktiv dhe vendimmarrje me kolegjalitet.

[1] - Raporti i Vleresimit per akreditimin institucional, fq 19

Struktura e ndërtimit funksional është e tillë ku përfaqësohen si stafi akademik, ashtu edhe ai administrativ në autoritete me karakter akademik dhe administrativ dhe organe kolegjiale akademike dhe administrative. Një ndarje e tillë i shërben efikasitetit në menaxhim dhe transparencës në ushtrimin e kompetencave.

UV në përbërje të tij ka 4 fakultete dhe 17 departamente. Risi për UV është edhe ngritja e një Bordi Këshillues (BK), me kompetenca këshillimore kundrejt Rektorit dhe Seantit Akademik, duke ndihmuar këto dy organe në vendimmarrje. Ligji i ri për arsimin e lartë thekson nevojën për rritjen e pjesmarrjes në vendimmarrje, përmes ngritjes së Komisioneve të Përhershme, të cilat priten të përcaktohen së shpejti në Statutin e Universitetit.

UV ka përcaktuar si pjesë të misionit të tij, ndërkombëtarizimin e veprimtarisë së tij, e shfaqur kjo edhe në dokumentin e Strategjisë së Ndërkombëtarizimit, por edhe në partneritetin që UV ka me IAL të tjera në nivel, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

2.3.BURIMET [2]

2.3.1Burimet njerëzore

UV ka miratuar dhe nënshkruar Kartën Evropiane për Kërkuesit dhe Kodin e Sjelljes për Rekrutimin e Kërkuesve në tetor të 2016, duke mbështetur zbatimin dhe efikasitetin e një politikëbërje mbi kërkimin më e drejtuar në të ardhmen e afërt në përputhje me Institucionet Evropiane të Arsimit të Lartë.

UV ndjek një politikë të qartë dhe transparente punësimi në përputhje me rritjen e numrit të studentëve dhe standardeve ndërkombëtare për raportin student/pedagog. Kriteret e punësimit për çdo vend vakant pune botohen në faqen zyrtare www.univlora.edu.al dhe në Buletinin javor të Agjencisë së Prokurimit Publik. Çdo hap i kësaj procedure, duke filluar nga kërkesa e departamentit për staf shtesë, publikimit, procesit të vlerësimit të kandidatit dhe vendimi i marrjes në punë, janë të dokumentuara në dosjet e personelit në zyrën e Burimeve Njerëzore.

Bazuar në këtë proces në vitin akademik 2018 - 2019, stafi akademik përbëhet prej mbi 200 pedagogë me kohë të plotë, nga të cilët 6 me titull Profesor Doktor; 27 me titull Profesor i Asociuar; 76 me gradë Doktor i Shkencave dhe një numër të konsiderueshëm në proces doktorature.

Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën në UV 82.49% % të personelit akademik që angazhohet në mësimdhënie, cikli I 90% (FSHT 94.00%, FE 98 %, FSHH, 80% %,FSHP 92,92 %)

[2] - Raporti i Vleresimit per akreditimin institucional, fq 20-27

2.3.2 Burimet financiare

Struktura e hartimit të buxhetit të UV, shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre bëhet në përputhje dhe sipas strukturës së Buxhetit të Shtetit, të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave (Udhëzimi nr. 2 datë 06.02.2012 i Ministrit të Financave, për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit; Udhëzimi nr. 677, datë 16.01.2015 i Ministrit të Financave, për një shtesë dhe një ndryshim në Udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 i Ministrit të Financave)

Për vitin 2017, është planifikuar rritje e të ardhurave në masën 29% më shumë se në 2016. Nga ky total, 49% e fondeve të llogaritura për vitin 2017 janë shpenzime personeli, 11% do të destinohen blerjeve të materialeve dhe shërbimeve, 19 % janë fonde për investimet kapitale (përfshirë këtu organizimin dhe pjesëmarrjen në konferenca dhe për botim artikujsh), dhe pjesa tjetër e mbetur janë fonde për likuidim të procedurave që kanë nisur në 2016 dhe do të përfundojnë gjatë vitit 2017.

2.3.3. Infrastruktura

Universiteti ka një infrastrukturë që nuk i përgjigjet plotësisht standardeve europiane për raportin numër studentës/sipërfaqe totale. Asetet e Universitetit paraqiten si më poshtë:

Tab Nr 1. Lista e aseteve të UV-së

<i>Nr</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Sipërfaqja e bazës</i>
1	Godina A	M ²	2640	660
2	Godina B	M ²	3000	750
3	Godina C	M ²	5000	1100
4	Biblioteka (20 * 12.5) tek Godina A	M ²	250	250
5	Auditoriumi “Rilindja” tek Godina A	M ²	300	300
	TOTALI	M²	11190	

UV disponon auditor mësimi, ambiente për laboratorë në fakultete, ambiente për personelin pedagogjik në departamentet përkatëse, ambiente për personelin administrativ pranë zyrave të rektoratit; ambiente teknike dhe magazinimi; dy (2) ambiente për bibliotekën, një (1) sallë Senati, 1 sallë audiovizive, tre (3) salla kompjuterësh dhe multimedieje. UV nuk e plotëson normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme (min: 3,8 – 4.0 m²/student dhe max: 7.5 – 8.0 m²/student), ndaj dhe punimet për rikonstruksionin e Godines B parashikojnë rritjen e kapacitetit të sallave, si dhe i është kërkuar pushtetit lokal dhe atij qendror një godinë e katërt për nevoja mësimdhënieje.

[2] - Raporti i Vleresimit per akreditimin institucional, fq 20-27

UV garanton kapacitete të mjaftueshme për formimin praktik të studentëve në programet e fushave si shëndetësi (laboratore dhe marrëveshje me Spitalin Rajonal Vlorë) dhe laboratore për shkencat teknike. Në funksion të mesimnxënies dhe punës së pavarur të studentëve, në respekt të ruajtjes së pronësisë intelektuale në Universitetin e Vlorës ekzistojnë dy biblioteka respektivisht:

<i>Nr.</i>	<i>Biblioteka</i>	<i>Sipërfaqe</i>	<i>Kapaciteti</i>	<i>Libra të ruajtur</i>
1	Godina A	250 m ²	70 vende	4930 volume
2	Godina B	60 m ²	30 vende	1350 volume
3	Godina C	0		

Sektori i Shërbimit të Librit pranë UV, ndjek një politikë të ruajtjes së trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore, duke shërbyer si institucion i depozitimit të infomacionit të shkruar dhe elektronik dhe të organizimit të aktiviteteve ku promovohen libra, autorë dhe tendenca bashkëkohore kulturore, shkencore e letrare.

Biblioteka e UV përdor programin COBISS.Net (i cili është sistem rajonal me shërbimet e përbashkëta bibliografike online) për katalogimin e përbashkët sipas standarteve ndërkombëtare të përshkrimit bibliografik, si proces i përpunimit të përbashkët të materialeve bibliotekare (libra, seriale, artikuj, materiale jolibër).

2.4 KURRIKULA [3]

UV, si IAL publik ofron programe studimi Bachelor (31 në total), Master Profesional (MP) (20 në total), Master i Shkencave (MS) (12 në total), Doktorale (1). Cdo Fakultet dhe Departament ka faqen zyrtare të internetit ku hedh të dhënat lidhur me programet e studimit që ofron për cdo cikël (Cikli I+II), planin e studimeve si dhe katalogun e studimeve. Gjithashtu në stendat e njoftimeve cdo departament afishon planin e studimeve, me të cilin njihen jo vetëm studentët, por edhe publiku i gjerë sa herë është prezent fizikisht në ambjentet e UV.

Në strategjinë e cdo njësie akademike dhe administrative të UV (Rektorat, Fakultet, Departament, Administratë) është mbajtura e kontakteve me shkollat e mesme për informimin e nxënësve me ofertën didaktike të UV, si dhe thithjes së studentëve cilësor. Kjo realizohet nëpërmjet ditëve të hapura informative në shkollat e mesme, kontakteve formale apo jo formale të autoriteve drejtuese të UV me drejtorët e shkollave të mesme, Drejtoritë Arsimore Rajonale, etj.

Zyra e Këshillimit të Karrierës, Transparencës Administrative dhe Alumni organizon cdo vit ditët e hapura për maturanët për t-i informuar ata rreth ofertës akademike, social kulturore që ofron UV.

[3] - Raporti i Vleresimit per akreditimin institucional, fq 28-37

UV ndjek një politikë të qartë për pranimin e studentëve në programet e studimit, bazuar në kritere. Në programet e studimit të ciklit të dytë (MS dhe MP), bazuar në propozimet e njësive bazë dhe kryesore, SA i UV-s miraton kriteret e pranimit për cdo program studimi të ofruar. Të gjitha programet e studimit që ofrohen nga UV janë të organizuara në mënyrë të kujdesshme, për të harmonizuar të gjithë komponentet e tyre, duke respektuar legjislacionin në fuqi lidhur me organizimin e programeve të studimit.

Kujdes tregohet që veprimtaritë formuese të programit të studimit të organizohen në disiplina të formimit bazë, disiplina të formimit karakterizues të programit, disiplina formuese të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, disiplina formuese të zgjedhura nga studentët, veprimtari formuese për njohjen e gjuhës së huaj, aftësi informatike, praktika apo stazhe, përgatitje e tezës së diplomës, si respektimi i shpërndarjes në përqindje të secilit grup të disiplinave të formimit dhe përcaktimit të krediteve lëndore.

UV nuk ka ofruar programe studimi të formimit të vazhduar deri në vitin akademik 2016-2017. Përpjekje po behen nga Fakultetet dhe Departamentet e UV për rritjen e ofertës didaktike edhe në drejtim të programeve të formimit të vazhduar. Neni 23, pika 1.b e Statutit të UV parashikon edhe studimet me kohë të pjesshme (pa shkëputje nga puna), si një formë e studimeve në UV. UV ka ofruar programe studimi me kohë të pjesshme kryesisht në fushat (ekonomi, juridik).

Në UV funksionon zyra Life Long Learnig (LLL) e cila ka si mision zhvillimin e misionit të tretë të universitetit, përfshirë identifikimin dhe analizën e nevojave për edukimin e vazhdueshëm gjatë gjithë jetës, si dhe organizimin e programeve të shkurtra të studimit për zhvillimin e kompetencave të reja profesionale, në ndihmë të studentëve, stafit dhe komunitetit në rajon.

UV nuk ka filiale të tij në vend. Programet e studimit ofrohen në përputhje me objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare, sic përshkruhet edhe në strategjinë dhe në statutin e tij. Të gjitha programet e studimit të UV synojnë të jenë në mbështetje të strategjive kombëtare dhe ndërkombëtare. Një pikë reference për objektivat ndërkombëtare është edhe strategjia Evropiane Adriatiko Ioniane (EUSAIR).

Politika e zhvillimit të UV, e përcaktuar qartazi në statutin dhe strategjinë e zhvillimit (Roli dhe misioni), orientohet në krah të politikave kombëtare. Oferta didaktike e UV është e larmishme, ku programet e studimit synojnë të jenë programe gjithëpërfshirëse aktivitetesh, ku multidisiplinariteti është tipar i këtyre programeve për zhvillimin e aftësive të studentëve. Multidisiplinariteti konsiderohet si pike e fortë e ofertes didaktike të UV (sidomos programet e ciklit të parë), cka lehtëson transferimin dhe fluiditetin në ndjekjen e programeve të ciklit të dytë dhe të tretë.

UV nuk ofron programe studimi të përbashkëta me IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit edhe pse ka patur përpjekje dhe iniciativë në kuadrin e projekteve ndërkombëtare, të cilat ende nuk janë finalizuar. UV do të vazhdojë të jetë e interesuar

për ofrimin e programeve të studimit të përbashket, me partner ndërkombëtare në kuadrin e financimeve dhe bashkëpunimeve Erasmus (Joint Master degree, Joint Phd)

Programet e studimit dhe planifikimi i kohës vjetore të punës së personelit akademik organizohen në menyrë që të harmonizojnë mësimdhënien e normuar, kërkimin shkencor dhe mbështetjen institucionale, e cila formalizohet nëpërmjet marrëveshjes që lidhet me fillimin e vitit të ri akademik midis personelit akademik dhe përgjegjësit të departamentit.

Te gjitha programet ciklit të parë janë të organizuara me 180 kredite dhe japin akses në oferten didaktike të ciklit të dytë të ofruar nga UV dhe IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit. Diversiteti i disiplinave të ofruara në programet e studimit të ciklit të parë mundeson një diversitet të oportuniteteve të studenteve për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë. Programet e studimit MS përcaktojnë edhe programet e studimit të ciklit të parë që sigurojnë pranimin pa debite formime dhe me debite formimi (deri në 60 kredite).

Në strategjinë e zhvillimit të UV 2008-2017 (roli dhe misioni) theksohet domosdoshmeria e hartimit dhe zbatimit të kurrikulave të përshtatshme, bazuar në sfidat e ekonomisë së tregut, jo vetëm kombëtar por edhe ndërkombëtar, për të pajisur dhe aftësuar studentet me njohuri që u lehtësojnë qasjen me tregun e punës kombëtar dhe rajonal/ndërkombëtar. Shembull shumë i mirë për këtë janë programet e studimit Bsc. Navigacion dhe Bsc. Inxhinieri Navale, hartuar duke marrë në konsideratë kurset standarte të "International Maritime Organisation" (IMO), shoqëruar edhe me guidën e studentit ku evidentohen mundësitë e punësimit që ofrojnë këto programe studime, në një treg pune jo vetëm kombëtar por edhe ndërkombëtar.

Në UV programet e studimit i nënshtrohen vlerësimeve periodike dhe analizave vjetore për të analizuar përfomancën e këtyre programeve dhe nxjerrjen e përfundimeve përkatëse. Bazuar në këto përfundime, indikacioneve që vijnë nga burime brenda dhe jashtë UV, si dhe ndryshimeve që pësojnë këto programe në universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit, programet e studimit në UV i nënshtrohen përmirësimit të vazhduar.

2.5 Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi [4]

Programet e studimeve të shpallura zbatohen në kushte të përshtatshme. UV siguron zbatimin në kushte të përshtatshme të programeve të studimit që ofron nëpërmjet organizmit të tyre në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Programet mësimore përmirësohen në mënyrë periodike dhe pas miratimit në Senat fillon zbatimi i tyre me fillimin e vitit të ri akademik.

UV siguron zbatimin në kushte të përshtatshme të programeve të studimeve të shpallura. Studentët e UV që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi, pajisen me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.

Në funksion të rritjes së cilësisë programet e studimeve që ofrohen në UV janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm të tyre, ndërkohë që UV ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

[4] - Raporti i Vlerësimit për akreditimin institucionale, fq 38-46

UV vlerëson rregullisht pedagogët në lidhje me zbatimin cilësor të programeve të studimeve jo vetëm në aspektin e mësimdhënies, por edhe në atë të kërkimit shkencor, kualifikimit dhe kontributit intelektual në institucion. Vlerësimi i pedagogëve kryhet edhe nëpërmjet plotësimit periodik të formularit të vlerësimit të kapaciteteve njerëzore në fushën akademike e kërkimore– shkencore

Në UV, departamenti si njësi bazë e institucionit, evidenton anët e tij të forta dhe dobësitë në fushën e kërkimit shkencor. Gjithashtu, UV inkurajon zhvillimin, dinamizmin dhe kërkimin shkencor nëpërmjet përqendrimit në ndërkombëtarizimin e kërkimit, përcaktimit të fushave parësore të kërkimit shkencor dhe zbatimit të prioriteteve kërkimore shkencore. UV siguron vazhdimësi në fushën e kërkimit shkencor, bën të njohura rezultatet dhe ndjek një politikë të vlerësimit dhe transferimit të këtyre rezultateve.

Cilësia e programeve të studimeve vlerësohet edhe nga statistikatat e punësimit të të diplomuarve në programet e studimit të ofruara nga UV. Nëse i referohemi FSHP, kalueshmëria e studentëve në provimin e shtetit për marrjen e licencës për ushtrimin e profesionit të infermierit për vitin 2016 ka qenë 68.7% (Bsc. Infermier i përgjithshëm) dhe 67% (Bsc Infermieri Mami). Gjithashtu, 38% e të diplomuarve në FSHP gjatë vitit 2016 kanë tërhequr programet e studimit për punësim jashtë shtetit. Janë tërhequr 20 suplemente diplome dhe 13 formularë për punë sezonale nga studentë që ende vazhdojnë studimet.

UV ndjek një veprimtari të qartë të zhvillimit të kërkimit shkencor në raport me kapacitetet e tij. Plotësimi i marrëveshjes për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik në IAL publike vlerëson edhe veprimtarinë kërkimore shkencore dhe për zhvillim e transferim teknologjie apo krijuese të personelit akademik.

Gjithashtu, politika e përfshirjes së studiuesëve të rinj në projektet kërkimore pasqyrohet në përfshirjen e studentëve të ciklit të parë, të dytë të studimeve në projekte kërkimore, si pjesë e vlerësimit vjetor të tyre në lëndë të caktura apo në udhëheqjen e një teme diplome nga pedagogët e UV në ciklet e studimeve master shkencor. UV ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik që angazhohet në veprimtari kërkimore shkencore.

Një pjesë e stafit akademik të UV janë lektorë në universitete të huaja. Për të nxitur rritjen e cilësisë dhe ndërkombëtarizimin e studimeve, fton, për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik të huaj, për periudha të kufizuara kohore.

Institucioni ndjek një politikë të vlerësimit dhe transferimit të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. Struktura e re organizative e miratuar e UV në përputhje me prioritetet për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe informacionin është konceptuar

në funksion të vlerësimit të ecurisë së rezultateve në fushën e kërkimit shkencor jo vetëm me emërimin e një zv. Rectori për Kërkimin shkencor por edhe me ngritjen e Njesisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë.

UV ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor nëpërmjet bashkëpunimeve dhe organizimit të konferencave të ndryshme. Gjithashtu, politika për mbrojtjen e pronësisë në veprimtarinë kërkimore-botuese; intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese reflektohet në dhënien e të drejtave ekskluzive për vetë studiuesit dhe organizimit të aktiviteteve ku promovohen libra, autorë dhe tendenca bashkëkohore kulturore, shkencore dhe letrare.

Aktivitete të ndryshme promocionale dhe komunitare kryesisht në fushën e shëndetit organizohen nga të gjitha departamentet. Nxitja dhe inkurajimi i UV për kërkuesit e rinj në ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor pasqyrohet në pjesëmarrjen e këtyre kërkuesve në konferenca dhe simpoziume të organizuar jashtë vendit, dhe që UV u mundëson rimbursim ekonomik të shpenzimeve. Për transferimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, UV bashkëpunon me biznesin vendas dhe të huaj dhe me faktorët ekonomikë dhe social që operojnë në territor.

2.6 Studentët dhe mbështetja ndaj tyre [5]

Pranimi i studentëve në UV, realizohet bazuar në nenin 74, 76 dhe 78 të Ligjit Nr. 80/2015, “PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” si dhe në vetë kriteret e parashikuara në nenin 25 dhe nenin 39 si dhe në kriteret e propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga SA i Institucionit.

UV bazohet në mësimdhënie bashkëkohore sipas standardeve ndërkombëtare dhe programet gjithpërfshirëse për zhvillimin e studentëve duke e sanksionuar këtë si pjesë e misionit të tij. UV merr çdo iniciativë me qëllim përmbushjen e kërkesave si pjesë e të drejtës së studimit në të treja nivelet [Neni 3 dhe Neni 4/3].

Institucioni është përzgjedhës në standardet e pranimi dhe synon si studentët tradicional edhe ata jotradicional. UV përpiqet në mënyrë të vecantë të lokalizojë dhe pranojë studentët me disavantazhe por që kanë një potencial të fortë për sukses akademik .

Informimi i studentëve të ardhshëm realizohet përmes Sektorit të Këshillimit të Studentëve që ka mbajtur emrin, Qendra e Këshillimit dhe Karrierës, Alumnit dhe Transparencës Administrative, e cila çdo vit organizon “ditën e dyerve të hapura” (open day) me maturantët.

UV ka ngritur struktura të veçanta për informimin dhe pritjen e studentëve të rinj. Qendra e Këshillimit dhe Karrierës, Alumnit dhe Transparencës Administrative, tani më Sektorit të Këshillimit të Studentëve, specialistët e së cilës këshillojnë studentët në procesin e regjistrimit. dhe fillimit të shkollimit. Asistojnë studentët përmes njohjes së legjislacionit, për mundësinë e përzgjedhjes së kurrikulave, pjesëmarrjen në organizime studentore, mundësinë e përfitimeve financiare etj. Sekretarët Mësimore

pranë cdo njësie bazë, janë kontakti i drejtpërdrejtë i studentit me UV, pasi e gjithë procedura e regjistrimit të tyre realizohet pikërisht pranë sekretarisë mësimore.

[5] - Raporti i Vleresimit për akreditimin institucional, fq 47-54

Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë, e cila pajis studentët me emrin identifikues dhe fjalëkalimin për të hyrë në sistemin online, si dhe udhëzon studentët mbi procedurat e regjistrimit. I gjithë funksionimi i IT rregullohet tani më sipas Rregullores së Programit të Dixhitalizimit Universitar ESSE3.

UV disponon mjete të komunikimit të jashtëm si dokumentat shkresore të protokolluara, si dhe të pajisura me firmën e autoritetit drejtues, vulën dhe logon e Institucionit. Si mjete për të realizuar komunikimin e jashtëm shërbejnë edhe telefonatat, email dhe tele-konferencat. Ëëbsite i UV është një mjet shumë i rëndësishëm për informimin e jashtëm por edhe të brendshëm.

Komunikimi i brendshëm i akteve dhe njoftimeve realizohet përmes shpërndarjes së tyre tek organet, autoritetet drejtuese apo të gjithë personelit akademik dhe administrativ përkundrejt nënshkrimit përkatës mbi marrjen në dijeni. Komunikimi i brendshëm mund të jetë edhe verbal, për çështje, natyra e të cilave e mundëson këtë lloj komunikimi. Për komunikimin e brendshëm Institucioni përdor edhe komunikimin virtual përmes emailit, njoftimet dhe komunikimet në “Këndin e Njoftimeve” kryesisht për studentët, si dhe përmes faqes zyrtare të UV.

UV ndjek një politikë mbështetëse për disa kategori të studentëve në nevojë, bazuar edhe në VKM me subjekt këto kategori . UV ndjek politika mbështetëse edhe për studentët me prejardhje nga minoritete të ndryshme (p.sh romë dhe ata ballkanoegjiptian). VKM që përcakton kategoritë e studentëve, që do të përjashtohen apo të cilëve mund t’u reduktohen tarifat e shkollimit, përfshin në këtë kategori edhe grupe të tjera si jetimët, fëmijët e ish- të dënuarve apo të përndjekurve politik, fëmijët e policëve apo ushtarakëve të Forcave të Armatosura, që kanë humbur jetën ose janë plagosur për shkak të detyrës (VKM nr. 911, datë 11.11.2015 dhe VKM Nr. 903, datë 21.12.2016, VKM). Institucioni ndjek politika mbështetëse për studentët që angazhohen në aktivitete sportive, jo vetëm përmes promovimit të këtyre aktiviteteve por edhe përmes mbështetjes financiare të ofruara ndaj studentëve që dallojnë në aktivitete të tilla.

Institucioni garanton për studentët e tij, jo vetëm tekstet mësimore bazë por edhe literaturën plotësuese të nevojshme të miratuar dhe të rekomanduar nga cdo departament. Tekstet mësimore që u ofrohen studentëve janë tekste të përzgjedhura, të cilat plotësojnë standardet e nevojshme për t’u përdorur si tekste universitare.

Literatura e ofruar nga Institucioni, përmes Bibliotekës së tij, është multidisiplinare. Në bibliotekë gjenden tituj nga 10 fusha të ndryshme studimi, të cilat janë të klasifikuara sipas Klasifikimit Dhjetor Universal (KDHU). Të interesuarit gjejnë në Bibliotekë literaturë për çështje të përgjithshme, për shkencën dhe diturinë, për filozofinë, psikologjinë, shkencat shoqërore dhe nëndarjet e tyre, ekonominë dhe nëndarjet e saj, drejtësinë, matematikën dhe shkencat e natyrës, shkencat e aplikuara si

mjekësia dhe teknologjia, linguistika dhe letërsia, gjeografia, historia si dhe materiale që trajtojnë artin, kulturën dhe sportin.

Institucioni u ofron studentëve të ciklit të parë mbështetje nëpërmjet shërbimeve universitare për të lehtësuar ecurinë e tyre. Institucioni, me qëllim realizimin e interesave dhe pritshmërive akademike të cdo studenti, ka ngritur strukturën e Koordinatorit Akademik të vendosur pranë cdo Njësie Bazë, të cilët orientojnë studentët në raport me programin e studimit. Koordinatori Akademik dhe Udhëheqësi Shkencor (USH) orientojnë dhe shoqerojnë studentin gjatë gjithë ciklit të studimit dhe kërkimit shkencor.

Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale. UV inkurajon pjesëmarrjen e studentëve jo vetëm në jetën studentore, por edhe në vendimarrje. KS janë një formë vetorganizimi e studentëve në rang fakulteti dhe në rang Institucioni, me qëllim promovimin dhe koordinimin e tyre për përfaqësim në organet drejtuese. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për të siguruar cilësinë e jetës studentore. Institucioni përpaket të sigurojë cilësinë e jetës studentore përmes veprimtarive të ndryshme që ai ofron. Ende ka punë për t'u bërë në lidhje me Kartën e Studentit, e cila edhe pse parashikohet në nenin 36 i Statutit ende nuk është implementuar konkretisht, kjo për shkak të nevojës së bashkëpunimit edhe me struktura të tjera si dhe me MASR.

UV ka një strukturë funksionale në lidhje me aktivitetet sportive sic është Qendra e Edukimit Fizik dhe Aktiviteteve Sportive, e cila ka si synim përfshirjen e studentëve në aktivitete sportive. UV po ashtu mbështet studentët që angazhohen në veprimtari sportive, duke u dhënë mundësinë atyre për të patur të gjitha llojet e faciliteteve për ushtrimin e aktivitetit të tyre.

UV u ofron mundësi ndihmë për integrimin në tregun e punës studentëve të vet sa përmes trajnimeve që ZKK organizon në lidhje me mënyrat e aplikimit për punësim, hartimin e një kurrikulumi, sjelljen gjatë një interviste pune etj, aq edhe përmes vetë aktiviteteve që ai organizon si panairi i punës. UV mban marrëdhënie me studentët Alumni duke synuar të mbetemi tërheqës, si dhe favorizues në procesin e punësimit e të diplomuarve të vet.

Analiza e detajuar e komponentëve të mësipërm jep inputet e para për një identifikim më të qartë të problematikave dhe përcaktimin e prioriteteve për vitet në vijim, prioritete të cilat do të përcaktojnë në planin afatgjatë vizionin e ri të UV-se.

2.7 UV - Praktika te mira/Sfida

Gjatë 24 viteve të aktivitetit të vet UV ka konsoliduar praktika të mira që janë reflektuar në ofrimin e shërbimeve më cilësore për studentin, në rritjen e nivelit të mësimdhënies përmes qasjeve innovative, në përshtatjen e aftësive profesionale të të diplomuarve me kërkesat e tregut të punës, në zgjerimin e bashkëpunimit dhe kooperimit me universitete të rajonit Ballkanik, Europian dhe me gjerë, rritjen e nivelit të punës kërkimore-shkencore të stafëve akademike dhe studentëve. Praktika të mira që përbëjnë edhe inpute konkrete për hartimin e Planit Strategjik përfshijnë:

- Rekrutimi i stafit akademik duke i dhënë prioritet rekrutimit të pedagogëve me grada dhe tituj apo atyre që janë diplomuar në Universitete të njohura dhe vlerësuara ndërkombëtarisht
- Rekrutimi i Studentëve përmes një strategjie të qartë të promovimit të talenteve dhe përfshirjes sociale të tyre që vijnë nga target grupe apo shtresa sociale vulnerabël
- Strategji marketing për të promovuar ofertën edukative dhe aktivitetin e UV
- Vlerësim periodik i cilësisë përmes Njesisë së Vlerësimit dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Institucionit.
- Bashkëpunim me stakeholdersat publikë, privatë në territor për analiza dhe studime kërkimore shkencore në funksion të zhvillimit rajonal
- Marrëveshje ndërkombëtare me universitete simotra në Europë dhe me gjerë në funksion të zgjerimit të mobiliteteve midis studentëve dhe pedagogëve.
- Projekte të përbashkëta ndërkombëtare që adresojnë problematikat e studentëve dhe arsimit të lartë në një kontekst European.

Universiteti krahas praktikave të mira përballet edhe me një numër sfidash që kondicionohen nga kuadri ligjor për arsimin e lartë, mungesa e një autonomie të plotë organizative dhe manageriale, mungesa e një strategjie të qartë kombëtare rreth figurave profesionale që ka nevojë tregu i punës në një kontekst më të gjerë se ai kombëtar, sfida infrastrukturore që lidhen me logjistikën bazë të nevojshme për t'i ofruar studentit një paketë të plotë shërbimesh edukimi, lehtësimi dhe suporti social.

I gjendur përpara konkurrencës së universiteteve në nivel kombëtar e më gjerë, UV është koshient për sfidën në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në fakultetet tona. Nëse cilësia e kontigjenteve ka ardhur në rritje, numri i studenteve që zgjedhin UV ka rënë që duke përcaktuar nevojën emergjente për rishikimin e prioriteteve tona bazuar në një analizë realiste SWOT për të përcaktuar pikat e forta, pikat e dobëta, oportunitetet për zhvillim dhe risqet me të cilat duhet të përballet UV

III. ANALIZA SWOT

PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBETA
1.Strukture organizimi efektive e njësive të UV. 2.Staf akademik të kualifikuar me grada kombëtare dhe ndërkombetare 3.Njohje dhe Zbatim i Ligjit të Arsimit të Lartë. 4.Diversiteti i cikleve të studimit reflektuar në një ofertë të larmishme programesh. 5.Cilësia në rritje e programeve të studimit të ofruara. 6.Procedurë e standartizuar mbi kontrollin e njohurive dhe vlerësimin e tyre. 7.Përdorim me efikasitet të teknologjisë së informacionit në menaxhimin e institucionit, procesin e mesimdhënie, komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm. 8.Pjesëmarrja në projekte dhe aktivitete kërkimore 9.Teknologji bashkekohore për organizimin dhe menaxhimin e UV, facilitimin e procesit të mesimdhënie, vlerësimit dhe komunikimit të përhershëm me studentët 10.Paketë shërbimesh të integruara për studentin duke përfshirë: Shërbime për studentin keshillim kariere, ambjente	1.Rrjedhje e stafit akademik të kualifikuar drejt institucioneve të tjera akademike apo publike në nivel qëndror, duke krijuar vakum të përkohshëm në burimet njerëzore, cka reflektohet në uljen e treguesve që masin cilësinë e tyre. 2.Infrastrukturë e kufizuar për zgjerim të programeve të studimit apo ngritje të qëndrave funksionale për kërkim shkencor, zhvillim të veprimtarive praktike, studim apo aktiviteteve të kohës së lirë për studentët. 3.Mungesa e strukturave akomoduese dhe mensave për studentët, c'ka rrit kostot që duhet të përballohen nga studentët gjatë një viti akademik. 4.Mungesa e programeve në të tre ciklet e studimit. 5.Mungesa e programeve të përbashkëta ndërkombëtare me universitetet homologe brenda dhe jashtë vendit. 6.Nivel i ulët i studentëve të Universitetit në një numër të konsiderueshëm programesh, c'ka afekton negativisht standardet e mesimdhënie nga ana e stafit akademik. 7. Numër i kufizuar i studentëve që aplikojnë dhe zhvillojnë mobilitete, që dëshirojnë të kryejnë eksperiencë të huaja studentore, në auditorë dhe jashtë tyre. 8.Mjedis social-kulturor jo favorizues për studentët, c'ka reflektohet në një

rekreative, Programe “Puno dhe Studio”, Bursat në bazë të nevojës financiare dhe të meritës, Programe exchange studentor në universitete prestigjioze jashte vendit. 11.Procedura te konsoliduara pritje dhe transferimi të studentëve të lëhtësuara nga implementimi i Kartës së Bolonjës.	ofertë të varfer argëtuese në mënyrë të vecantë për studentët e Qendres Studentore. 9. Nivel i ulët i gjuhëve të huaja të zotëruara nga stafi akademik duke mos krijuar mundësi reale për hapjen e programeve nsërkombëtare të studimit për të tërhequr studentë ndërkombëtarë.
Mundësitë 1.Politikat proaktive të Qeverisë qëndrore, për plotësimin e nevojave të universiteteve me burime infrastrukturore dhe staf akademik efektiv janë në përputhje me nevojat e UV për zgjerim dhe rritje në infrastrukturë cilësore dhe staf të ri akademik të mirëpërgatitur. 2.Kuadri ligjor aktual për Arsimin e Lartë, krijon mundësi për forcimin e demokracisë në jetën universitare, për ndarjen sa më mirë të përgjegjësisë, rritjen e përgjegjshmërisë së organeve drejtuese të institucionit në menaxhimin e burimeve njerezore, materiale e financiare. 3.Marrëveshjet e Bashkëpunimit me universitetet simotra brenda dhe jashtë vendit qe janë nënshkruar apo janë ende në process. 4.Aderimi i UV në rrjete ndërkombëtare të edukimit, EUCEN Rrjeti European i Institucioneve te Arsimit Profesional, ASEK – Rrjeti i Universiteteve te zones Mesdhetare dhe Detit të Zi.	Kërcënimet 1.Konkurenca e fortë prej universiteteve e tjera publike në vend, të përqëndruar në zonën e kryeqytetit. 2.Rritja universiteteve private. Rritja e numrit të universiteteve private sjell rënie të kërkesës së studenteve për të ndjekur studimet në universitetin tonë. 3.Tërheqja e stafit efektiv akademik nga konkurrentët e UV-së. Permes mekanizmit të ofrimit të pagave më të larta në raport me publikun. 4.Programe studimi vetëm në gjuhën shqipe te cilat pengojne dhe krijojne barriera të lëvizjes së studentëve nga universitete të huaja. 5. Nuk ofrohet mësim me kohë të pjesshme / part –time. Per kushtet e veshtiresise ekonomike, UV nuk jep zgjidhje per studime në komunitet. 6.Barriera arkitektonike për PAK. UV nuk është i pajisur me rampa dhe ashensor për personat me aftësi të

5. Përfshirja e UV në projekte ndërkombëtare të financuara me fonde të donatorëve të huaj apo programeve të financuara nga KE. 6. Marrëveshjet e nënshkruara me institucione të qeverisjes qendrore, rajonale dhe lokale, organizata përfaqësuese të biznesit, organizata të shoqërisë civile. 7. Bashkëpunimi me biznese të ndryshme, sidomos në qytetin e Vlores në rritjen e performancës së studenteve dhe rritjen e mundësisë për punësim të menjëhershëm pas diplomimit.	kufizuar. Kjo kufizon profilin gjithëpërfshirës të UV. 7. Mundësi të limituara të programeve të studimit në ciklin e tretë (doktoraturës) të cilat limitojnë numrin e pedagogëve që mund të risin kualifikimin e tyre. 8. Niveli i ulët i gjuhëve të huaja që zotërojnë studentët redukton mundësitë e tyre për t'u përfshirë në programe ndërkombëtare mobiliteti. 9. Burime financiare të limituara që krijojnë mundësinë e punësimit të pedagogëve të huaj me grada dhe tituj shkencorë.
---	---

IV. KUADRI STRATEGJIK

Vizioni dhe strategjia për zhvillimin e institucionit kanë në themel të strukturës së tyre historikun e universitetit, burimet njerëzore dhe financiare, partneritetin me institucionet publike dhe private, konsultimet me të gjithë aktorët bazuar në qasjen bottom – up.




V. VIZIONI

Universiteti i Vlorës Ismail Qemali i krijuar për të qenë në shërbim të dijes, edukimit dhe mirëqënies së shoqërisë shqiptare, synon të mbetet një universitet publik i njohur dhe i kërkuar në territorin e Shqipërisë dhe më gjerë në rajon, duke u mbështetur fuqishëm në vlerat e tij në mësimdhënie cilësore, kërkim dhe hulumtim profesional, integritet dhe dinjitet social.

UV shikon me prioritet të ardhmen në mijëvjeçarin e ri në drejtim të vendosjes së qëndrueshme të standarteve të cilësisë së veprimtarisë së tij mësimdhënëse edukuese për formimin e studentëve si leader profesionistë me mundësi konkurrimi në tregun botëror, në zhvillimin e punës akademike kërkimore e krijuese për rritjen e rolit drejtues të institucionit në progresin ekonomik dhe social të rajonit jugor të vendit dhe më tej. Universiteti synon të shndërohet në një sistem referimi për shoqërinë për të edukuar anëtarët e vet me ndjenjën e përgjegjshmërisë, respektimin e vlerave të përbashkëta shoqërore që qëndrojnë në themel të shoqërisë: lirinë, demokracinë, familjen, mireqënien ekonomike, paqen sociale.

Duke shpjeguar në detaje, vizioni kryesor i UV-së është të ketë një ndikim transformues në shoqëri, përmes inovacionit të vazhdueshëm në arsim, hulumtimin, kreativitetin të lartë dhe pjesëmarrjes aktive në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Sektorët kryesorë ku UV synon të jetë drejtues dhe orientues i zhvillimit, janë:



Të gjitha drejtimet e mësipërme do të arrihen në bazë të vlerave që mbizotrojnë në institucionet e arsimit të lartë, por edhe në vlerat tradicionale me të cilat shoqëria shqiptare (dhe sidomos ajo vlonjate) është e fuqizuar me fokus:

- Respektimi i diversiteteve dhe dhënia e mundësive të barabarta;

- Përgjigjet efektive dhe në kohë ndaj sfidave shoqërore - sociale në plan lokal, rajonal, kombëtar dhe global.
- Integriteti në respektimin e standardeve më të larta etike në sjelljen personale dhe profesionale.
- Menaxhim transparent dhe llogaridhënie
- Kreativiteti i pasqyruar në mbështetjen e ideve të reja dhe formave të shprehjes;
- Barazim për hulumtim dhe mësimdhënie
- Edukim i vazhdueshëm
- Investimi te studentët dhe në stafin ekselent
- Ndjeshmëri dhe dëshirë në përmirësimin e shoqërisë dhe në zhvillimin personal të anëtarëve të komunitetit;
- Qëndrueshmëria në ruajtjen dhe mbrojtjen e burimeve natyrore.

Vizioni i Universitetit është ndërtuar i bazuar mbi besnikërinë dhe angazhimin e të gjithë anëtarëve të tij. Në këtë kontekst, Universiteti ka hartuar këtë strategji që implementon politika të mundësive të barabarta dhe gjithëpërfshirëse duke kundërshtuar çdo formë të diskriminimit të demokracisë.

VI. *MISIONI*

UV si institucion autonom publik i arsimit të lartë, zhvillon shërbim edukimi akademik, veprimtari shkencore dhe kërkimore, mbështetje dhe këshillim profesional për studentë dhe kërkues shkencorë në fushat e tyre të interesit.

Ne synojmë të krijojmë një universitet në shërbim të vlerave më të larta njerëzore, promotor të zhvillimeve në territor, me shërbime cilësore dhe të integruara jo vetëm në rajonin e Vlorës, por në të gjithë Shqipërinë.

Ne synojmë të formojmë dhe të përgatisim, studentë premtues, profesionistë cilësorë në perputhje me trendin e tregut të punës, profesionistë dhe shkencëtarë në shërbim të zhvillimeve dinamike jo vetëm në kontekstin kombëtar, por edhe në atë europian e më gjerë, duke kapërcyer çdo barrierë të lidhur me prejardhjen e tyre sociale, ekonomike, kulturore apo etnike sipas parimeve të zhvillimit njerëzor të OKB-së.

Roli dhe misioni i UV-s bazohet në këto shtylla kryesore:

1. **MËSIMDHËNIA DHE STUDIMI.** UV synon të jetë një institucion aktiv në implementimin e dijes, gjenerimin e ideve krijuese dhe nxitjen e shkencës në territorin e Shqipërisë, nëpërmjet një mësimdhënieje bashkëkohore sipas të gjitha standardeve ndërkombëtare, standardeve Europiane ESCO, Deklaratës së Bolonjës dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.
2. **PROFILI INSTITUCIONAL.** Të krijojë një profil LIDER në zhvillimin e arsimit, shkencës, sportit dhe kulturës, zhvillimin territorial në tërësi, duke përcaktuar në bashkëpunim të ngushtë me stakeholdersat e tjerë, rritjet e rritjes së ekonomisë dhe zhvillimit të shoqërisë në rajon dhe më gjerë.

3. **EDUKIMI I VLERAVE:** Të luajë një rol përcaktues dhe dominues në edukimin e vlerave qytetare dhe demokratike për integrimin e shoqërisë shqiptare në shoqërinë europiane.
4. **KËRKIMI SHKENCOR.** Të zhvillojë standartet më të larta për punë kërkimore shkencore bazë dhe të aplikuar me impakt ekonomik dhe social të fuqishëm në rajon duke respektuar autorësinë dhe pronësinë intelektuale.
5. **INFRASTRUKTURA.** Të krijojë një infrastrukturë moderne, inovative, miqësore me mjedisin, pa barriera për PAK duke ofruar një paketë të plotë shërbimesh të integruara për studentët, stafin akademik dhe komunitetin në tërësi, përmes shfrytëzimit me efektivitet të burimeve financiare.
6. **BASHKEPUNIMI/PARTNERITETI.** Të ndërtojë partneritet të qëndrueshëm me institucionet publike, private, organet e medias, shoqërisë civile, organizatave të biznesit dhe grupeve të tjera të interesit në funksion të përmbushjes së standardeve të mësimdhënies, fuqizimit institucional dhe zhvillimit të territorit.
7. **NDËRKOMBËTARIZIMI.** Të integrohet plotësisht në zonën europiane të arsimit të lartë, duke punuar në drejtim të internacionalizimit të institucionit në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
8. **SIGURIMI I CILËSISË DHE STANDARTEVE.** Të respektojë dhe të zhvillojë punë akademike të cilësisë së lartë në përputhje me standartet europiane ESCO të Komunitetit Evropian.
9. **PËRFSHIRJE dhe PERGJEGJËSI SOCIALE.** UV do të synojë të krijojë një paketë të integruar shërbimesh për të krijuar një mjedis mundësues dhe favorizues studimi për të gjithë studentët më mundësi të kufizuara financiare, me probleme sociale individuale dhe familjare. UV do të implementojë CRS (Corporate Social Responsibility) duke ofruar shërbime të efektshme dhe ndikuese në publik dhe në komunitet, programe gjithëpërfshirëse aktiviteteve në ndihmë të grupeve të marginalizuara shoqërore.


Misioni i UV-s është i orientuar edhe në DIMENSIONIN SOCIAL duke synuar në keto drejtime:

1. Të kontribuojë në promovimin dhe përhapjen e njohurive shkencore tek studentët nëpërmjet ofrimit të një game të gjerë të disiplinave të mësimdhënies dhe kërkimit.
2. Të sigurojë mjetet e nevojshme për një karrierë të suksesshme për studentët, për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.

3. Të sigurojë një rol udhëheqës në ekonominë lokale si edhe në zhvillimin kulturor të qytetit të Vlorës dhe më gjerë.
4. Të ndihmojë në përmbushjen e nevojave sociale, kulturore dhe zhvillimore të vendit.

Formulimi i mësipërm i misionit bazohet edhe në Ligjin Nr 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Veçanërisht, është me vlerë për t'u theksuar komponenti arsimor i Universitetit dhe roli i tij në formimin e qytetarit modern për të siguruar arsimimin/edukimin si një e mirë dhe e drejtë shoqërore publike.

VII. FJALET KYCE



VIII. SKENARET E ZHVILLIMIT

Skenarët e mundshëm të zhvillimit të UV ne 5 vitet e ardhshme janë rrjedhojë e një analize të detajuar të situatës aktuale, vlerësimit të oportuniteteve me realizëm,

përputhshmërinë e tyre me politikat aktuale kombëtare për arsimin gjithëpërfshirës, si dhe trendin global të zhvillimit të qëndrueshëm.

Skenarët e zhvillimit në planin afatmesëm dhe afatgjatë:

1. NDERKOMBETARIZIM/GLOBALIZIM I UV

1. SMART UV

1. LIDER PROFESIONAL

Këta skenarë nuk qëndrojnë të mëvetësishëm, por janë të lidhur ngushtë ashtu siç janë tiparet e një institucioni dhe sektorët e tij të zhvillimit. Prandaj dhe skenarët mund të zhvillohen njëkohësisht, në një mënyrë të integruar dhe përplotësuese, për të arritur një zhvillim më të larmishëm.


IX. LINJAT STRATEGJIKE

Në përputhje me skenarët e zhvillimit të përcaktuar më sipër nga aktorët e konsultuar ne UV janë përcaktuar linjat strategjike për çdo skenar zhvillimi në përputhje të plotë me objektivat për një zhvillim të qëndrueshëm.

Linjat strategjike përcaktojnë qartësisht prioritetet për çdo skenar zhvillimi duke detajuar edhe nga pikpamja metodologjike skenarin e zhvillimit. Mbi bazën e linjave strategjike të hartuara dhe aprovuara do të hartohen udhezuesit strategjike dhe planet e veprimit.

Metodologjia e hartimit thjeshtëzon procesin e monitorimit të Planit strategjik dhe lehtëson rishikimin e tij në përputhje me zhvillimet dinamike të Universitetit në 5 vitet e ardhshme.

SKENARI I



UV do të këtë si skenar zhvillimi në 5 vitet e ardhshme ndërkombëtarizimin e tij përmes krijimit të partneriteteve të qëndrueshme ndërkombëtare, intensifikimin e programit të mobiliteteve afatshkurtra dhe afatgjata të studentëve dhe pedagogëve, rritjes së cilësisë së kërimit shkencor duke nxitur kërkimin e përbashkët në fusha me interes ndërkombëtar, krijimin e një mjedisi mundësues për pjesëmarrje dhe organizim të konferencave shkencore ndërkombëtare të studentëve dhe pedagogëve, zgjerimit të bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare duke ofruar asistencë teknike profesionale në fusha të zhvillimit social ekonomik rajonal.

Linja strategjike Nr 1/ Partneritet dhe kooperim ndërkombëtar

- Aderimin e UV-së në rrjetet ndërkombëtare universitare dhe jo vetëm me synim promovimin e UV në nivel ndërkombëtar, por njëkohësisht edhe rritjen e kapaciteteve falë shkëmbimit të informacionit me Universitetet elitare globale.
- Forcimin e pozitave në rrjetet ndërkombëtare ku aderon prej disa vitesh si rrjeti EUCEN, ASEK etj përmes një pjesëmarrjeje aktive në asamblatë e këtyre rrjeteve dhe përfaqësimit në organet drejtuese të tyre.
- Identifikimin e Universiteteve prioritarë për të bashkëpunuar në 5 vitet e ardhshme bazuar në standardet e mesimdhënies, kurrikulave, kapacitetet inovative trajnuese të stafit akademik dhe atij administrativ dhe nënshkrimin e marrëveshjeve institucionale të bashkëpunimit.
- Rishikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare të nënshkruara dhe rinegocimin e tyre në përputhje me prioritetet institucionale dhe interesin e përbashkët të bashkëpunimit.
- Marrëveshje të nënshkruara për krijimin e qendrave të përbashkëta studimore duke patur në fokus si Marrëveshjet kuadër ashtu edhe ato të nënshkruara në

kuadër të implementimit të projekteve të përbashkëta në fushën e kërkim zhvillimit.


- Partneritete të qëndrueshme për aplikime projektsh ndërkombëtare në kuadër të programeve të financuara nga Komuniteti Evropian ku përshihen Programet ndërkufitare dhe transnacionale të kooperimit IPA CBC, Adrijon, Med Balkan, Med Modular, Horizon 2020, Erasmus.

Linja strategjike Nr 2/ Programe ndërkombëtare studimi dhe mobilitete afatgjata

- Identifikimi i kapaciteteve reale të stafit akademik aktual për të ofruar programe ndërkombëtare studimi në fusha me interes për studentë internacionalë.
- Hartimi i një strategjie afatgjatë për tërheqjen e stafit akademik ndërkombëtar përmes ofrimit të kontratave specifike të punësimit dhe fleksibilitetit në ngarkesën mësimore.
- Gjenerimin e programeve të përbashkëta të studimit në të tre ciklet me Universitete ku ka përputhshmëri programesh dhe ngarkese mësimore të njëjtë për cdo lëndë.
- Nënshkrimin e Marrëveshjeve të bashkëpunimit për ICM – International Credit Mobility Programs (Erasmus+ KA1) me Universitete prestigjioze duke patur në konsideratë kapacitetin mësimdhënës, infrastrukturën në funksion të mësimdhënies, diversitetin kulturor dhe social.
- Nënshkrimin e Marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit dhe partneritetit me universitete lider në zonën Europiane për aplikime të përbashkëta në kuadër të programeve Erasmus + (KA2), Horizon 2020.
- Ndërkombëtarizimi i kurrikulave duke i përfshirur ato me kurrikulat e studimit të universiteteve europiane.
- Krijimin e një sistemi ndërkombëtar vlerësimi sipas standardeve ESCO të KE-së, c'ka mundëson lehtësimin e mobiliteteve dhe njohjen e diplomave në nivel evropian.
- Krijimin e një pakete të plotë edukimi (program ndërkombëtar) dhe shërbimesh të integruara (akomodimi+argëtim) për studentë ndërkombëtarë për të zhvilluar mobilitete afatgjata pranë UV.
- Nxitjen e studentëve dhe stafit akademik për të aplikuar dhe për të zhvilluar mobilitete ndërkombëtare afatgjata pranë Universiteteve europiane dhe me gjerë.
- Hartimin e Programeve ndërkombëtare afatshkurtra apo programe trajnimi ndërkombëtar me interes për studentët dhe stafin akademik.
- Krijimin e Programeve Verore “Summer School” duke krijuar mundësi socializimi dhe shkëmbimi kulturor midis të rinjve.
- Përfshirjen e organizatave rinore studentore në Programin Ndërkombëtar të të rinjve Youth Exchange Program dhe programin ndërkombëtar të vullnetarizmit përmes akreditimit të Universitetit si institucion pritës dhe dërgues i të rinjve.

Linja strategjike Nr 3: Kërkim shkencor i përbashkët sipas standardeve ndërkombëtare

- Përfshirjen e stafit akademik dhe studentëve në veprimtari të përbashkëta kërkimore shkencore ndërkombëtare.
- Hartimin e politikave stimuluese financiare për studentët dhe pedagogët e UV për të marrë pjesë në konferenca shkencore ndërkombëtare.
- Krijimin e qendrave të përbashkëta kërkimore shkencore duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për kërkues ndërkombëtarë
- Organizimin e Konferencave ndërkombëtare në partneritet me Universitete prestigjioze Europiane.
- Botimin e punimeve shkencore të studentëve dhe pedagogëve në revista prestigjioze shkencore me faktorë të lartë impakti
- Bashkëpunimin me organizata ndërkombëtare si UNDP, Banka Botërore, GIZ, Kooperacioni Zviceran, Kooperacioni Italian që operojnë në territorin shqiptar dhe me gjerë për të ofruar ekspertizë në realizimin e studimeve shkencore për zhvillimin territorial.
- Organizimin e Konferencave Ndërkombëtare studentore duke patur në fokus këndvështrimin e të rinjve për çështje sensitive të shoqërisë globale.

SKENARI II

Universitet SMART si skenar zhvillimi do të fokusohet në shfrytëzimin me efektivitet të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit në sistemin e menaxhimit dhe organizimit të universitetit duke përsosur sistemin SIUV, procesin e mësimdhënies dhe kontrollit përmes aplikimit të metodave inovative të mësimdhënies (e- learning, e- classroom), procesit të pranimit, regjistrimit dhe ofrimit të shërbimeve për studentët përmes përmirësimit të sistemit UMS, zgjerimit të target grupit të studentëve përmes ofrimit të kurseve online të studimit, krijimit të një infrastrukture moderne me shërbim interneti broadband cilësor, shfrytëzimit në mënyrë efektive të burimeve të energjisë, promovimit të një sistemi të qëndrueshëm të trajtimit të mbetjeve, krijimit të një mjedisi infrastrukturor miqësor me mjedisin.

Linja strategjike Nr 1/ EDUKIMI SMART

- Vetëdrejtimi – Ndryshimi i rolit të studentit nga konsumator në ofrues, i rolit të pëdagogut nga një përcues i njohurisë në një edukator mentorues inteligjent.
- Sistem vetëdrejtimi të mësimdhënies me përshkrim dhe vlerësim të dijeve përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit. Përmirësimi i UMS.
- Motivimi – Nryshimi i metodës së të nxënës nga ajo e bazuar në tekste standard tek të mësuarit duke u bazuar në zgjidhjen e problemeve në mënyrë kreative bazuar në një process individual vlerësimi.
- Proces edukimi të adaptueshëm duke ofruar fleksibilitet në sistemin e dukimit dhe një eksperiencë të personalizuar të të nxënës të bazuar në preferencat individuale për karriere, duke kaluar nga koncepti i njohurisë për masen në njohuritë e individualizuara bazuar në aftësinë e studentit për të nxënë.
- Nje treg të hapur për ofertën edukative të bazuar në shërbimet Cloud te edukimit duke patur akses në sistemet e hapura ku ente publike, private, individë, shkencëtarë kanë një hapësirë për të ndarë kontributin e tyre shkencor në funksion të mësimdhënies dhe transferimit të njohurive.
- Infrastrukturë teknologjike avangardë për të patur akses pa limit në sistemet e hapura të edukimit që ofrojnë mundësi të pakufizuara të mësimxënies pavaresisht vendit dhe kohës duke garantuar opsione të shumta edukimi.

Linja strategjike Nr 2/ SISTEM SHËRBIMESH SMART

- Përdorimi i teknologjisë së informacionit për të dhënë një informacion të plotë rreth procedurave të pranimit dhe regjistrimit në Universitet, kostove të edukimit, organizimit dhe menaxhimit të Universitetit.
- Përdorimi i aplikacioneve mobile në mënyrë që studentët të kenë akses të vazhdueshëm për informacion dhe komunikim me stafin akademik dhe atë administrativ.
- Përmirësimi i sistemit UMS duke ofruar më shumë mundësi interaktiviteti student pedagog, jo thjesht të përqendruar në sistemin e regjistrimit, vlerësimit

të provimeve të pjesëshme apo finale, por edhe në hapësira diskutimi të personalizuar sipas interesave të studentit.

- Përmirësimi i sistemit të informimit të UV duke shtuar paketën e shërbimeve për studentët, në mënyrë të vëçantë për studentët jo rezidentë dhe studentet ndërkombëtarë. Për këta të fundit paketa e shërbimeve duhet të përfshijë edhe praktikën që duhet të ndiqet edhe për marrjen e lejes së qëndrimit pranë zyrave të emigracionit, informacion të kompletuar për akomodimin, transportin dhe cdo informacion tjetër të vlefshëm.
- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit on line duke vendosur në kontakt në kohë reale stafin administrativ me atë akademik duke shmangur komunikimin verbal dhe atë shkresor për problematika rutinë të lidhura me procesin mësimor dhe aktivitetin normal që zhvillojnë departamentet dhe fakultetet.


Linja strategjike Nr 3/ INFRASTRUKTURE SMART

- Rrjet komunikimi broadband cilësor në të gjitha ambientet e aksesueshme nga studentët Universitet, salla leksioni, ambientet relaksuese përreth universitetit, strukturat e akomodimit, bibliotekë.
- Sistem avangard hardëar-esh me akses të pakufizuar të studentëve dhe stafit akademik.
- Struktura laboratorike moderne, lehtësisht të aksesueshme nga studentët dhe padagogët, të pajisura me mjetet më bashkëkohore të analizave laboratorike, eksperimenteve dhe projektimit.
- Pajisje me software bashkëkohorë sipas nevojës për formimin e figurave profesionale në përputhje me nevojat e tregut të punës në ekonomi, inxhinieri, shërbime sociale, mësimdhenie.
- Sistem autonom të energjisë përmes instalimit të paneleve diellore në ndërtesat dhe strukturat akomoduese dhe regjim eficient shfrytëzimi.
- Sistem ekologjik të trajtimit të mbetjeve duke përfshirë krijimin e një praktike të konsoliduar të ndarjes në burim, riciklimit dhe ripërdorimit.
- Intensifikim i bashkëpunimit me biznesin për të krijuar struktura moderne analize dhe përpunimi informacioni për studime, projekte të kërkuara prej tyre.

SKENARI III

Universiteti do të synojë të shndërohet në një institucion lider përsa i takon formimit profesional në përputhje me standardet Europiane ESCO - Standardi European i Kualifikimit të Kompetencave/Aftësive profesionale dhe punësimit që përcaktojnë qartësisht Setin e Kompetencave Profesionale dhe atyre Interpersonale që duhet të fitojnë të diplomuarit.

Plotësimi i këtyre standardeve kërkon rishikim të programeve të studimit për t'i përshtatur me kërkesat e tregut të punës në kontekstin Europian, rishikimin dhe përmirësimin e procesit të mësimdhënies bazuar në krijimin e kompetencave profesionale përmes përdorimit të metodave interaktive që nxisin kreativitetin dhe të menduarin kritik dhe jo thjesht dhënien e njohurive të bazuara në tekste.



Ne vetvete ky proces do të kërkojë përpara së gjithash rritjen e nivelit të stafit akademik, trajnimin e vazhdueshëm të tij në institucione të njohura ndërkombëtarisht për metodologjinë e mesimdhënies të bazuar në kompetenca.

Studentët, të diplomuarit, stafi akademik dhe administrativ do të përfshihen në një program intensiv trajnimi dhe kualifikimi duke respektuar procesin e të nxënës gjatë gjithë jetës LLL (Life Long Learning). Trajnime kombëtare dhe ndërkombëtare në bashkëpunim institucional me partnerët ndërkombëtarë do të jenë pjesë e paketës së formimit të vazhdueshëm profesional e cila do të reflektohet në Planin vjetor të trajnimeve të stafit akademik dhe administrativ të UV.

Diplomimi, vlera e diplomës së fituar në tregun e punës dhe punësimi do të jenë sfida jonë kryesore në 5 vitet e ardhshme. Bashkëpunimi me biznesin nëpërmjet marrëveshjeve institucionale ddo të shërbejë si një mekanizëm efektiv për të identifikuar nevojat e tregut të punës për figura të caktuara profesionale.

Kërkimi shkencor në Universitet mund t'i shërbejë realizimit të një studimi të tillë. Lidhja e studentëve me biznesin në vitet e para të studimit, zhvillimi i internshipeve, praktikave mësimore, trajnimeve në vendin e punës etj do të shërbejnë si instrumente efektive për rekrutimin dhe punësimin e të diplomuarve në sektorin

privat. E njëjta strategji do të ndiqet edhe me institucionet publike për të optimizuar mundësitë për punësim në rajon dhe më gjerë.

Dimensioni social do të përshkojë këtë skenar zhvillimi duke ofruar një sistem suporti moral dhe financiar për studentë që vijnë nga grupe të disavantazuara shoqërore: personat me aftësi të kufizuara PAK, studentë që vijnë nga minoritete etnike rom dhe egjiptiane, studentë që vijnë nga familje me problematika të theksuara sociale.

Politika sociale mbështetjeje në tërësi për target grupet e sipërpërmendura si dhe ato favorizuesë për të rinj të talentuar të të njëjtit grup do të jenë në fokus të diskutimit të organeve drejtuese dhe vendimmarrëse të Universitetit.

Linja strategjike Nr1: ESCO Standard

- Trajnimi i stafit akademik dhe atij administrativ mbi standardet ESCO – Standardi European i Klasifikimit të Aftësive Profesionale dhe Punësimit
- Njehsimi i sistemit aktual të vlerësimit me vlerësimin sipas standardeve ESCO (profesionale dhe interpersonale) c’ka mundëson njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave në nivel European dhe lehtëson procesin e transferimit dhe mobiliteteve të studentëve dhe të diplomuarve.
- Përmirësimi i syllabuseve për çdo program studimi bazuar në setin e kompetencave profesionale dhe interpersonale për çdo cikël studimi bazuar në standardet ESCO
- Rishikimin e veprimtarisë së zyrës së orientimit dhe karrierës bazuar në ESCO standard, duke orientuar fokusin dhe shërbimin e zyrës drejt punësimit sipas qasjes “Coach for Employment”
- Përmirësimin e procesit të mësimdhënies bazuar në ESCO standards duke u fokusuar në krijimin e kompetencave individuale, kreative dhe nxitjen e talenteve.
- Bashkëpunimin me biznesin për të sjellë procesin e mësimdhënies më pranë problematikave të biznesit, duke orientuar studentin drejt identifikimit praktik të problemit dhe gjetjes së zgjidhjes.
- Marrëveshjet e bashkëpunimit me biznesin, institucionet publike, shoqërinë civile për të afruar studentin me praktikën duke i dhënë mundësi të testojë njohuritë teorike të fituara.

Linja Strategjike Nr 2./ SPIN OFF/ START UP

- Përmirësimi i programeve të studimit duke përfshirë elementë të sipërmarjes dhe duke i orientuar studentët që në fazën e studimeve drejt saj.
- Krijimin e një strukture specifike “Inkubatorë biznesi”, qëllimi i së cilës është të asistojë studentët me ide biznesi për t’i shndëruar ato në plane të mirëfillta biznesi dhe implementuar në të ardhmen

- Krijimin e një programi spin off-i (acelerim të start up-eve) për të ofruar trajnim, asistencë teknike dhe ekspërtizë të kualifikuar të rinjve studentë apo të diplomuar që kanë ide inovative biznesi.
- Krijimin e një mekanizmi financiar të tipit “Fond garancie” që financon idetë e biznesit në fazën e testimit dhe inkubimit.
- Bashkëpunimin me biznesin, institucionet publike, shoqërinë civile, mediat për të krijuar fondin e sipërmarrjes sociale për të rinj të diplomuar me aftësi të kufizuar apo status social vulnerabël.
- Përfshirjen e UV-se në mënyrë institucionale me marreveshje të nënshkruara në programet kombëtare dhe europiane të start up-eve si “Social Impact”, Java Europiane e Start Up-eve, etj duke krijuar mundësi për studentët dhe të diplomuarit të përfitojë fonde nga Komuniteti Evropian për ngritjen e sipërmarrjeve të tyre.

Linja strategjike Nr 3/ Diploma, Punësimi

- Rritja e vlerës së diplomës në tregun e punës duke rritur nivelin e aftësive të përfituara gjatë periudhës së edukimit.
- Krijimi i një sistemi eficient të gjurmimit të studentit pas përfundimit të studimeve, krijimi i një data base të detajuar të dhënash
- Realizimi i kërkimeve shkencore të strukturuar, për të vlerësuar vlerën e diplomës në tregun e punës referuar pagesës në vitin e parë të punësimit.
- Takime frekvente me sektorin publik dhe privat, diskutime në fokus-grupe për të marrë feedback rreth të diplomuarve të punësuar dhe performancës së tyre në punë.
- Identifikim i vazhdueshëm i nevojave të biznesit për aftësi specifike profesionale, përshtatja e programeve duke përfshirë module për aftësitë e kërkuara apo krijimi dhe ofrimi i programeve afatshkurtëra.
- Bashkëpunim i ngushtë me biznesin për zhvillimin e praktikave sipas qasjes “on the job training” duke përcaktuar qartësisht modalitetet e bashkëpunimit.
- Nxitjen e biznesit për të investuar në një infrastrukturë moderne laboratorike dhe praktike, si nje investim afatgjatë për profesionistët e rinj, që do të jenë të punësuarit e nesërm pranë këtyre bizneseve.
- Zgjerimi i aktivitetit të zyrës së karrierës me shërbime në funksion të punësimit të studentëve duke luajtur rolin e intermediar-it midis tregut të punës dhe universitetit.

Linja strategjike Nr 4/ Life Long Learning

- Krijimi i një modeli efikas të LLL Life Long Learning – të mësuarit gjatë gjithë jetës bazuar në modelet më të përparuara rajonale dhe evropiane.

- Hartimi i moduleve specifike, bazuar në nevojat dhe kërkesat e tregut të punës dhe krijimi i një programi të konsoliduar trajnimesh.
- Përdorimi i teknikave dixhitale për të rritur aksesin e të rinjve në sistemin LLL përmes ofrimit të kurseve online.
- Takime dhe bashkëpunim frekuent me biznesin për të identifikuar nevojat e tyre për formim në vazhdimësi të personelit, përfshirë edhe profesionistët e diplomuar në Universitet.
- Aderimi me të drejta të plota në Rrjetin Europian EUCEN të qendrave të të mësuarit gjatë gjithë jetës LLL.
- Ofrimi i kurseve të përbashkëta afatshkurtëra online me Qendrat LLL pranë universiteteve europiane dhe me gjerë.
- Ngritja e partneriteteve dhe implementimi i projekteve të përbashkëta ndërkombëtare me fokus qendrat LLL.

Linja Strategjike Nr 5/ Dimension Social

- Krijimi i një data base të plotë të studentëve që vijnë nga target grupet sociale vulnerabël minoritete etnike rom dhe egjyptiane, studentë nga familje me problematika të theksuara sociale.
- Hartimi i politikave sociale dhe instrumentave financiarë për të rritur oportunitetet e këtyre target grupeve për të qenë profesionistë kompetitivë në tregun e punës.
- Përfshirja e studentëve të tjerë në aktivitete konkrete suporti dhe mbështetje për profesionistët që vijnë nga shtresat vulnerable.
- Ofrimin e oportuniteteve për zhvillim mobilitetesh ndërkombëtare.
- Aktivizimin e të rinjve studentë të të gjitha shtresave dhe kategorive në aktivitete të suportit social, bamirësisë, ofrimit të shërbimeve për target-grupe specifike .

VII. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Analiza SËOT vendos në plan të parë domosdoshmërinë për të ndërtuar strategjinë e zhvillimit të UV duke përcaktuar si prioritet:

- **Vazhdimësia.** Universiteti ka si qëllim dhe mision të tij primar vazhdimin e traditës. Edhe pse një Universitet relativisht i ri (vetëm 23 vjet), Universiteti bazohet në një traditë të konsoliduar, duke u zhvilluar në shumë drejtime; si në shkencat ekonomike (traditë që buron prej Shkollës Tregtare në Vlorë), shkencat detare (traditë që buron prej Shkollës së Marinës), shëndetit publik (traditë që buron prej Shkollës Mjekësore), pedagogjisë së specializuar (traditë që buron prej Shkollës Pedagogjike).

- **Zhvillimi.** Synimi i Universitetit është jo vetëm të ruajë traditën e tij, por njëkohësisht të zgjerojë dhe të zhvillojë degë të tjera të kërkuara nga tregu si; Drejtësia, Shkencat Kompjuterike, si dhe programe studimi profesionale një dhe dy vjeçare dhe tekniko-profesionale.
- **Vlerat bazë të universitetit për vitet e ardhshme.** UV që prej krijimit të tij është i përqëndruar në vlerat që ndjekin Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri e më gjerë si; liria akademike, rritja e njohurive të stafit dhe studentëve, mirëkuptimi, respektimi i etikës, llogaridhënia, transparenca, përgjegjësia, etj.

STRATEGJIA E BRENDSHME AFATMESME

Mbi këto drejtime të mësipërme, grupi i punës ka projektuar strategjinë e brendshme afatmesme për periudhën e caktuar duke identifikuar:

OBJEKTIVA TË ORGANIZIMIT INSTITUCIONAL.

1. Zhvillimi dhe forcimi i identitetit akademik dhe profesional për fushat e studimit që mbulon UV
2. Forcimi i lidhjeve me tregun e punës nëpërmjet zyrës së karrierës dhe qendrës RDC për më shumë informacion mbi kërkesat dhe mundësitë e punësimit
3. Asistencë dhe mbështetje për avancimin akademik të stafit të UV

OBJEKTIVA TË HARTIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT:

1. Përmirësimi i vazhdueshëm dhe pasurim i planeve dhe programeve ekzistuese
2. Mbështetje e studentëve në mendimin objektiv mbi cilësinë e programeve dhe nevojave për ndryshim
3. Vëmendje mbi ndryshimet e kërkesave të tregut të punës dhe projektimin e programeve të reja të studimit në mënyrë dinamike
4. Përzgjedhje e metodologjive bashkëkohore në hartimin e programeve të reja në përputhje me sfidat e vendit për integrim ndërkombëtar.

OBJEKTIVA TË IMPLEMENTIMIT TË PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT:

1. Analizë dhe verifikim i mjediseve ekzistuese dhe nevojave të reja për implementim programesh të reja
2. Investime në bazë materiale dhe laboratorike për implementim të metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies

3. Identifikim i burimeve njerëzore që do të mbështesin mësimdhënien dhe kërkimin

OBJEKTIVA TË PARTNERITETIT NDËRKOMBËTAR

1. Zbatimi dhe aktivizimi i marrveshjeve të lidhura me universitetet partnere brenda dhe jashtë vendit.
2. Fokusimi tek partnerët strategjike dhe diversifikimi i lidhjeve
3. Anëtarësimi dhe aktivizimi në shoqata dhe organizma ndërkombëtare për promovimin e profilit të UV në kuadër ndërkombëtar

OBJEKTIVA TË KËRKIMIT SHKENCOR

1. Rritje e aktivitetit hulumtues në departamente dhe qendrat shkencore
2. Rritje e numrit të botimeve të punimeve krijuese e shkencore në revista ndërkombëtare me impakt
3. Nxitje dhe mbështetje e shkrimit të monografive dhe librave të hartuar nga bashkëpunimi i stafit akademik sipas profileve
4. Nxitje dhe motivim për stafin kërkues në zgjidhjen e problemeve sociale dhe ekonomike të rajonit.
5. Strukturim më i mirë i informacionit mbi kërkimin shkencor dhe patentimi dhe regjistrimi i propozimeve shkencore me impakt ekonomik apo social

STRATEGJIA E BRENDSHME AFATGJATË

Kjo strategji shtrihet në një afat kohor mbi periudhën afatmesme dhe mbështetet në të njëjtat objektiva, duke vënë theksin mbi vazhdimësinë e objektivave më sipër me fokus të specifikuar si më poshtë vijon:

OBJEKTIVA TE ORGANIZIMIT INSTITUCIONAL.

1. Zhvillimi dhe forcimi i identitetit akademik dhe profesional për fushat e studimit që mbulon UV duke forcuar lidhjet me tregun e punës nëpërmjet mekanizma të specializuar duke parë me prioritet investime në infrastrukturë të burimeve njerëzore dhe cilësinë e tyre.

OBJEKTIVA TË HARTIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT:

1. Përmiresimi i vazhdueshëm dhe pasurim i planeve dhe programeve ekzistuese duke monitoruar impaktin social të procesit.

2. Krijimi dhe konsolidimi i kushteve për studime të nivelit të tretë për të plotësuar ofertën akademike të studimeve në UV.
3. Ndërtimi i mekanizmave për të marrë feedback të studentëve të diplomuar në elemente të proceseve dhe shërbimeve në UV
4. Vëmendje e vazhdueshme mbi ndryshimet e kërkesave të tregut të punës dhe projektimin e programeve të reja të studimit në mënyre dinamike
5. Marrje dhe implementim i modeleve nga IAL-të partnere ndërkombetare për të rritur performancën e UV mes konkurrentëve në sistemin e arsimit të lartë.

OBJEKTIVA TË IMPLEMENTIMIT TË PROGRAMEVE TË REJA TE STUDIMIT:

1. Mbështetje e studentëve me diversitete në ekonomi, racë dhe kombësi nëpërmjet gjithëpërfshirjes dhe bursave të studimit.
2. Implementim i programeve të reja me në qendër studentin për një identitet dhe personalitet të formuar si qytetar europian

OBJEKTIVA TE PARTNERITETIT NDERKOMBETAR

1. Rritja e numrit të marrveshjeve aktive me impakt pozitiv në kërkim dhe mobilitete studente dhe staf akademik
2. Bashkëpunimi për ngritjen e programeve të studimit të përbashkëta me partnere ndërkombetare
3. Rritja e bashkëpunimit me partnerë brenda dhe jashtë vendit në projekte europiane për rritje kapacitetesh dhe zhvillim kurrikulash.
4. Rritje vëmendje e fokusim tek partnerët strategjike dhe diversifikimi i lidhjeve me ta.

OBJEKTIVA TE KERKIMIT SHKENCOR

1. Rritje e aktivitetit hulumtues në departamente dhe qendrat shkencore
2. Rritje e numrit të botimeve të punëve krijuese e shkencore në revista ndërkombëtare me impakt
3. Nxitje dhe mbështetje e shkrimit të monografive dhe librave të hartuar nga bashkëpunimi i stafit stafit akademik sipas profileve
4. Nxitje dhe motivim për stafin kërkues në zgjidhjen e problemeve sociale dhe ekonomike të rajonit.
5. Strukturim më i mirë i informacionit mbi kërkimin shkencor dhe patentimi dhe regjistrimi i zgjidhjeve shkencore me impakt ekonomik apo social

Po kështu UV i jep rëndësi të veçantë:

- Ekselencës.
- Vlerave të diversitetit.

- Barazisë sociale
- Respektimit të kërkimit shkencor dhe mësimdhënies.
- Edukimit të vazhdueshëm.
- Ambicieve rajonale dhe kombëtare.

Për përmirësimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet që Universiteti kryen, politikat dhe masat operative që propozohen si pjesë e kësaj Strategjie, e drejtojnë UV në mënyrë të qëndrueshme në përmbushjen e objektivave ekzistuese si dhe hartimin e objektivave të reja në përputhje me rritmet dinamike të zhvillimit të tij.

Konkretisht:

- Krijimi i një profili dhe reputacioni Rajonal, Kombëtar e Ndërkombëtar, deri më 2023;
- Mbështetja e kërkimeve të reja dhe inovacionit, për të prodhuar njohuri dhe rezultate kërkimore shkencore bashkekohore në dispozicion të së mirës dhe interesit publik;
- Garantimi i studentëve një formim cilësor dhe të qëndrueshëm si shkencor ashtu dhe profesional i cili do të jetë i bazuar tek një staf pedagogjik i kualifikuar dhe specializuar;
- Avancimi dhe modernizimi i infrastrukturës kërkimore shkencore;
- Hapja ndaj tregut për burime shtesë të financimit për kërkim shkencor; përmes rritjes së bashkëpunimit me partnere të qëndrueshëm të biznesit.
- Lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien dhe shpërndarja sa më e gjerë e rezultateve të kërkimit;
- Promovimi i bashkëpunimit ndër-disiplinor dhe ndër-universitare në kërkime shkencore në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Krijimi (ose/edhe përmirësimi) i partneriteteve të reja mes Universitetit të Vlorës dhe të autoriteteve lokale dhe rajonale;
- Rankimi si Universiteti i parë në Shqipëri, deri në vitin 2023 për cilësinë;
- Rankimi si Universiteti i parë në Shqipëri, deri në vitin 2025 për kërkimin shkencor;
- Krijimi i programeve një dhe dy vjeçare;
- Përmirësimi i kapaciteteve për zhvillimin dhe edukimin e vazhdueshëm;
- Krijimi dhe kultivimi i mëtejshëm komuniteteve të personalizuara studentore;
- Menaxhimi i besueshëm, transparent dhe efikas i burimeve financiare.

PLANI I VEPRIMIT

2018 -2024

SKENARI I

NDERKOMBETARIZIMI/GLOBALIZIMI I UV-se

Linja Strategjike	Objektivat Strategjike	Veprimi	Instrumentat	Afati	Pergjegjesit	Kosto(ne 000 leke)
Linja strategjike Nr 1	Rritja e numrit të marreveshjeve aktive me	1.Aderimi i UV-së në rrjetet universitare dhe profesionale	-aplikime per anetaresim -pageses se kuotizacionit vjetor -pjesemarrjes ne takimet e asambleve dhe bordeve drejtuese.	2018 – 2024	Rektorati Fakultetet, Njesite baze,	3,700

Partneritet dhe kooperim ndërkombëtar	impakt pozitiv në kërkim dhe mobilitete studente dhe staf akademik					
		2. Forcimi i pozitave në rrjetet ndërkombëtare ku aderohet prej disa vitesh si rrjeti EUCEN, ASEK	- pjesëmarrja aktive në asambltë e këtyre rrjeteve - zgjedhje dhe përfaqësim në organet drejtuese të tyre.	2018 -2020	Rektorati Fakultetet, Njesite baze,	500
		3. Identifikimi i Universiteteve prioritarë për të bashkëpunuar në 5 vitet e ardhshme bazuar në nivelin e rankimit dhe reputacionin ndërkombëtar	- hartimi i nje data base te plote te Universiteteve qe paraqesin interes bashkepunimi. -organizimi i vizitave te ndersjellta per te formalizuar bashkepunimin -hartimi i Marreveshjeve kuader te bashkepunimit. -hartimi i Marreveshjeve specifike per krijimin e qendrave te perbashketa te kerkimit shkencor	2018-2019	Rektorati Fakultetet, Njesite baze Drejtoria Sigurimit te cilesise dhe Marredhenieve me Jashte	200
		4. Rishikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare të nëshkruara dhe rinegociimit të tyre në përputhje me prioritetet institucionale dhe interesin e	- hartimi i nje data base me Marreveshjet e nëshkruara ne vitet paraardhese. - Identifikimi i Marreveshjeve qe jane jashte afatit.	2018-2019	Rektorati Fakultetet, Njesite baze Drejtoria Sigurimit te	300

		përbashket të bashkëpunimit.	- Hartimi i termave të references për Marreveshjet e reja apo updejtimi i atyre ekzistuese - Nenshkrimi i Marreveshjeve të reja		cilesise dhe Marredhenieve me Jashte	
		5.Krijim Partneritetesh të qëndrueshme për aplikime projektsh ndërkombëtare në kuadër të programeve të financuara nga Komuniteti Evropian ku përshihen Programet ndërkufitare dhe transnacionale të kooperimit IPA CBC, Adrijon, Med Balkan, Med Modular, Horizon 2020, Erasmus.	- Hartimi i data base-it të parnereve të ndare sipas programeve - Perditesim i Partner Data Form (formati baze për partneritet) bazuar në projektet e implementuara vit pas viti.	2018 -2019	Drejtoria Sigurimit të cilesise dhe Marredhenieve me Jashte	150
